 <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	Politika mbi gjurmueshmërinë e matjeve	Kodi DA-PO-008
		Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
		Faqe 1 nga 2

Politika mbi gjurmueshmërinë e matjeve

1. Qëllimi

Ky dokument përshkruan politikën e Drejtorisë së Akreditimit në lidhje me gjurmueshmërinë e matjeve.

2. Referimet

ILAC Policy ILAC-P-10:2002 “ILAC Policy on Traceability of measurement results”
ISO/IEC 17025:2005, paragrafi 5.6 -“ Kërkesa të përgjithshme për kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues.”

3. Politika e DA në lidhje me gjurmueshmërinë e matjeve


3.1 Organizmat e akredituar nga DA duhet të demostrojnë që kalibrimi i pajisjeve dhe rezultatet e testimit/inspektimit të dalin nga këto pajisje brenda fushës së akreditimit janë të gjurmueshme në lidhje me njësitë e sistemit SI.

Drejtoria e Akreditimit e njeh rastin, që për shkak të natyrës së disa testeve nuk është e mundur të pritet gjurmueshmëria e rezultateve të matjeve. Këto raste përcaktohen nga Drejtoria e Akreditimit në varësi të kërkesës për akreditim.

3.2 Gjurmueshmëria për pajisjet apo kalibrimet brenda fushës së akreditimit nga laboratorët kalibrues të akredituar duhet të rrjedhë nga:

- Direkt nga një institut kombëtar i metrologjisë i përshtatshëm
- Një laborator kalibrues i cili mund të demostrojë kompetencë, aftësi matëse dhe gjurmueshmëri të shoqëruara me pasigurinë e matjeve si psh. një laborator kalibrues i akredituar.

Për Drejtorinë e Akreditimit një institut kombëtar i metrologjisë i përshtatshëm konsiderohet ai që merr pjesë rregullisht dhe në mënyrë të suksesshme në krahasimet ndërlaboratorike.

 <p>DAV Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<p>Politika mbi gjurmueshmërinë e matjeve</p>	<p>Kodi DA-PO-008</p>
		<p>Rishikim nr 0 Dt ____/____/____</p>
		<p>Faqe 2 nga 2</p>

3.3 Drejtoria e Akreditimit i kërkon laboratorëve testues dhe organizmave inspektues të akredituar që të sigurojnë gjurmueshmërinë e kalibrimeve të brendshme të tyre rezultateve të testeve/inspektimeve të akredituara kur përdoret një kalibrim i jashtëm i cili është i akredituar për pasiguri të vogla të arsyeshme. Gjithashtu laboratorët mund të demonstronë kompetencën e tyre:

- tek një institut kombëtar i metrologjisë ose laborator kombëtar reference
- me një material referues të certifikuar ose metodë të pranuar.

Kur kalibrimi i pajisjeve konsiderohet teknikisht i pamunduar është e pranueshme për laboratorët testues dhe organizmat inspektues të kalibrojnë pajisjet e tyre në mënyrë kompetente kundrejt standardeve referues që janë të kalibruar nga laboratorë kalibruar të akredituar ose kundrejt etaloneve kombëtare të matjeve. Në këtë rast vlerësuesit e DA do të kërkojnë sigurimin e gjurmueshmërisë së brendshme të laboratorit nëpërmjet ekzaminimit të sistemit të kalibrimit të laboratorit apo organizmit inspektues në vlerësimet e tyre. Gjithashtu për ekzaminimin e kompetencës së laboratorit për të kryer matje të përshtatshme, vlerësuesit duhet të kenë parasysh përshtatshmërinë e standardeve referuese që laborator/organizmi inspektues ka dhe aftësinë e organizmit për të kalibruar instrumentat e punës kundrejt standardeve referues.

Certifikatat e kalibrimit të lëshuara nga prodhuesit apo agjentët e tyre nuk janë tregues të pranueshëm të gjurmueshmërisë së jashtme. Certifikatat e kalibrimit pranohen vetëm nëse ato janë lëshuar në përputhje me pikën 3.2.

Data

Drejtori i Përgjithshëm